



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr. 07/351-51052

Dt. 27.02.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit pranë Komunës së Gjakovës duke vendosur sipas kërkesës së aplikuesit: **Agim (Ibrahim) Kameri** nga Gjakova, për zgjatjen e afatit të Lejes së Ndërtimit të dhënë më parë, për ndërtimin e objektit të banimit individual, bazuar në **Aktvendimin me nr 05 - 351-1441, të datës 02.12.1991 në emër të Hate Cahanit (ish pronar I ngastrës me nr. 205/0, ZK:Jahoc)**, në bazë të Ligjit të Ndërtimit Nr. 04/L-110 neni 21 pika 7, Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për planifikim dhe ndërtimin e objekteve në teritorin e komunës së Gjakovës, si dhe nenit 11 të Ligjit për Procedurën Administrative Nr 02/L-28 të datës 22 korrik 2005, bie këtë:

AKTVENDIM

I. I LEJOHET: aplikuesit: **Agim (Ibrahim) Kameri** nga Gjakova, zgjatja e afatit të Lejes Ndërtimore për ndërtimin e objektit të banimit individual, të dhënë më parë bazuar në **Aktvendimin me nr 05 - 351-1441 të datës 02.12.1991, në emër të Hate Cahanit (ish pronar I ngastrës me nr.205/0, ZK:Jahoc)**, në ngastrën kadastrale me nr. 205/0, Z.K.: Jahoc, në pronësi të të lartëpërmendurit, sipas dokumentacionit të prezentuar (Çertifikatës mbi të drejtat e paluajtshmërisë me nr të lëndës 3-17, të datës 04.01.2017 dhe Kopjes së Planit, dt.04.11.2017 të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.

Bazuar në procesverbalin e Inspektorit të ndërtimtarisë me Nr.14 Nr.354-Ndërtimit, dt.20.02.2017, me rastin e kontrollit në vendin e ngjarjes, si dhe fotot nga vendi i ngjarjes, është konstatuar se në ngastrën 205/0, ZK: Jahoc, investitori deri më tani nuk e ka filluar ndërtimin.

II. Zgjatja e afatit të lejes së ndërtimit bazohet në Situacionin sipas Kopjes së Planit të datës 17.10.1991, Aktvendimin e Lejes Ndërtimore me nr 07/351-1441 të datës 02.12.1991 në emër të Hate Cahanit ((ish pronar I ngastrës me nr.205/0, ZK:Jahoc).

III. Zgjatja e afatit të Lejes Ndërtimore bëhet për periudhën në kohëzgjatje prej një viti nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

IV. Pjesë përbërëse e dokumentacionit janë siq vijon:

- Aktvendimin e Lejes Ndërtimore me nr 07/351-1441 të datës 02.12.1991, lëshuar nga Sekretariati për Urbanizëm, punë komunale e strehimore I komunës së Gjakovës.
- Kopja e Planit e datës 17.10.1991.
- Çertifikata mbi paluajtshmërinë me numër të lëndës 3-17, të datës 04.01.2017, lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
- Kopja e Planit e datës 04.02.2017, lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
- Plani i Situacionit në përpjesë 1:500, e datës 09.11.2016 I vërtetuar nga DUMM.
- Projekti kryesor I punuar nga Shoqata Akcionare "Ening" - Gjakovë.
- Kontrata Noteriale, mbi Shitblerjen e paluajtshmërisë, me nr.LRP nr.1345/2017, ref.nr.207/2017., dt.16.02.2017.
- Deklaratën-Pëlqimin, nga Noteri, me nr.LRP.Nr.1326/2017, dt.16.02.2017.

- Deklaratën-Pëlqimin, nga Noteri, me nr.LRP.Nr.1388/2017, dt.20.02.2017.
- Procesverbalin e Inspektorit të ndërtimtarisë me Nr.14 Nr.354-Ndërtimit, I datës 20.02.2017, si dhe fotot nga vendi I ngjarjes.
- Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatami në prone, nr.430/B/595, dt.29.12.2016.

A r s y e t i m

Agim (Ibrahim) Kameri nga Gjakova, me banim në rrugën "Lekë Dukagjini" nr.102, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr.07/351-51052 të datës 29.12.2016 për zgjatjen e afatit të Lejes së Lejes Ndërtimore, të dhënë më parë, për ndërtimin e objektit të banimit individual, bazuar në **Aktvendimin me nr 05 - 351-1441 të datës 02.12.1991, në emër të Hate Cahanit (ish pronar I ngastrës me nr.205/0, ZK:Jahoc)**, në ngastrën kadastrale me nr. 205-0, Z.K.: Jahoc.

Vërejtje: Zgjatja e afatit të Lejes së Ndërtimit bazuar në Aktvendimin me nr 07/351-1441, të datës 02.12.1991 në emër të Hate Cahanit (ish pronar I ngastrës), tashmë lëshohet në emër të Agim (Ibrahim) Kameri (bashkëpronarit aktual të ngastrës), bazuar në dokumentacionin e prezentuar Certifikatës mbi të drejtat e paluajtshmërisë me nr të lëndës 3-17, të datës 04.01.2017, I, dhe Kopja e Planit e datës 04.02.2017, lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.

Pala e ka plotësuar dhe dorëzuar dokumentacionin siq është parashtruar dhe në dispozitiv të këtij Aktvendimi.


Kompenzimi për obligimet komunale në bazë të Vendimit mbi ndryshimin dhe plotsimin e Rregullores mbi tarifat dhe ngarkesat nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale, Neni 5, par. 5.6, e fuqizuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës me 01 Nr.011-43964/2015 të datës 22.02.2017, është paguar në vlerën prej 30.0 Euro, në PTK, filiala në Gjakovë.

KËSHILLË JURIDIKE:


Kundër këtij aktvendimi pala e paknaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke e llogaritur ditën e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë të Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor në Prishtinë, dhe e njejta dorëzohet nëpërmjet kësaj drejtorie

Me Aktvendim të njoftohen: Parashtruesi i kërkesës, Inspektori i Ndërtimtarisë, dhe arkiva.

Zyrtar i lartë për çështje juridike


Zenel Shabani, jur. dipl.

U. D. Drejtori,


Elida Bejtullahu, inxh.e dipl.e ark.

KOPJE PLANI

Zona kad. Jahoc


Poseduesi: 2/6 Kameri Agim (Ibrahim)



Numri rendor i regjistrimit të taksave kadastrale: _____

Nr. Parcelës	Plani	Vendi i quajtur	Kultura	Klasa	Sipërfaqja			Vërejtjet
					Ha	a	m ²	
205-0			livadh	6		14	41	
Gjithsejtë						14	41	

Që kjo kopje e planit është besnike e origjinalit të vet sipas gjendjes në kadastër duke paguar taksën sipas vendimit të KK GJAKOVË.



VERIFIKON:
[Signature]